



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 73

Prill

2011

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i GJEDNJ
datë 8.8.2011

Mbi pranimin e aplikimit nr. 52531/07 nga Selami Zalli
kundër Shqipërisë.....

3

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM MBI PRANIMIN E Aplikimit nr. 52531/07 nga Selami Zalli kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt) e mbledhur më 8 shkurt 2011 në një dhomë të përbërë nga:

Nicolas Bratza, president

Sverre Erik Jebens,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Zdravka Kalaydjieva,

Nebojša Vučinić,

Vincent A. de Gaetano, gjykatës,

dhe Lawrence Early, sekretar

duke marrë parasysh aplikimin e mësipërm të paraqitur më 1 nëntor 2007,

duke marrë parasysh vërejtjet e paraqitura nga qeveria përgjegjëse, si edhe vërejtjet e dorëzuara si kundërpërgjigje ndaj të parave nga pala aplikuese,

pasi ka shqyrtuar çështjen, vendos si më poshtë:

FAKTET

Aplikuesi, z.Selami Zalli, është nënshtetas shqiptar i lindur në vitin 1961 dhe banues në Tiranë. Aktualisht ai është nëpunës ligjor në Gjykatën e Lartë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u prezantua nga përfaqësuesja e saj, znj. E.Hajro.

Faktet e çështjes, të paraqitura nga palët, mund të përmbliken si më poshtë.

A. Transferimi i aplikantit dhe procedurat konsekuente juridike

Në nëntor të vitit 1993, aplikuesi u caktua si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë (PRRT). Nga korriku i vitit 1994 deri në maj të vitit 2001, aplikuesi ishte prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme (PP).

Në vitin 2001, Prokurori i Përgjithshëm (PP) propozoi që aplikuesi të transferohej në një tjetër prokurori rrethi, si rezultat i së cilës ai do të ulej në detyrë dhe të ardhurat e tij do të zvogëloheshin. Aplikuesi e kontestoi propozimin me pretendimin se nuk kishte asnjë arsye për transferimin dhe zbritjen e tij në detyrë.

Në maj të vitit 2001, Këshilli i Prokurorisë e mbështeti propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në 1 qershor të vitit 2001, në saje të një dekreti presidencial, transferimi i aplikuesit u vu në zbatim. Në po të njëjtën ditë, aplikuesi mori përsipër funksionet e tij si prokuror i Prokurorisë së Rrethit Pogradec. Paga e tij bazë u përgjysmua.

Në nëntor të vitit 2001, aplikuesi paraqiti një apel kushtetues në Gjykatën Kushtetuese kundër dekretit presidencial.

Në 21 shkurt 2002, Gjykata Kushtetuese e deklaroi të papranueshme ankesën e tij për mosshfrytëzim të të gjitha mjeteve juridike, sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës.

Në 18 mars 2002, aplikuesi e paraqiti për diskutim transferimin e tij përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit). Ai argumentoi se transferimi dhe zbritja e tij në detyrë ishin në kundërshtim me aktin e prokurorisë dhe ndikuan negativisht në karrierën e tij, në të ardhurat dhe në shpenzimet përkatëse.

Në 15 prill të vitit 2002, Gjykata e Rrethit vendosi ta transferonte çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit), me pretendimin se i mungonte juridiksioni. Ajo arsyetoi se transferimi i aplikuesit ishte pak a shumë një masë disiplinore, për të cilën Gjykata e Apelit kishte juridiksion fillestar në zbatim të paragrafit 34 të akteve ligjore të prokurorisë.

Në një datë të papërcaktuar, ndërsa procedurat ishin ende pezull përpara Gjykatës së Apelit, aplikuesi bëri kërkesë për kompensim për humbjen e të ardhurave si rezultat i transferimit. Në kërkesat e tij përfundimtare ndaj Gjykatës së Apelit, aplikuesi argumentoi se gjykata në fjalë ishte kompetente për shqyrtimin e çështjeve në lidhje me transferimin e prokurorëve. Ai pretendonte se transferimi i tij kishte qenë kundër së drejtës civile, duke qenë se ai nuk kishte shprehur opinionin e tij; transferimi nuk kishte qenë në të njëjtin nivel hierarkik dhe në vijim, ulja në detyrë nuk kishte qenë e përkohshme. Ai pohoi se kishte patur rënie të fitimeve si rezultat i transferimit.

Në 18 shtator 2002, Gjykata e Apelit doli në mbështetje të aplikuesit dhe e shfuqizoi dekretin presidencial. Ajo pohoi se transferimi i aplikuesit kishte ndikuar në punësimin e tij, duke rezultuar në një ndryshim në pozicionin e tij dhe në një ulje në pagesë. Gjykata interpretoi paragrafin 24 të akteve të prokurorisë, për të theksuar faktin se aplikuesit i ishte kërkuar miratimi për transferim, në mungesë të së cilit procedura nuk do të ishte në përputhje me ligjin. Kërkesa e aplikuesit për kompensim për rënie të fitimeve nuk u përmend.

Në 15 tetor 2002, Prokuroria e Përgjithshme apeloi në Gjykatën e Lartë.

Në 30 tetor 2002, në përpjekje për të harmonizuar praktikën juridike *inter alia* me karakterin ligjor të dekretit presidencial dhe me përputhshmërinë e tij me aspektin juridik, Presidenti i Gjykatës së Lartë vendosi se çështja duhej studiuar nga Kolegjet e Bashkuara.

Në 30 janar 2003, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shfuqizuan vendimin e Gjykatës së Apelit me 10 vota kundër 5 të tillave, duke deklaruar se një dekret presidencial nuk është i kushtëzuar nga aspekti juridik përse i përket emërimit në detyrë, transferimit ose heqjes nga detyra të një prokurori, për shkak të marrëdhënies së veçantë që ekzistonte midis shtetit dhe nëpunësve të tillë në lidhje me punësimin. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën ta ndërprisnin çështjen.

Në 10 qershor 2003, aplikuesi apeloi në Gjykatën Kushtetuese. Ai argumentoi se vendimi i datës 30 janar 2003 kishte thyer të drejtën e tij, për qasje në një gjykatë. Më tej ai deklaroi se dekreti i kryetarit, i cili urdhëronte transferimin e tij ishte një akt administrativ që kushtëzohej nga aspekti juridik.

Në 23 dhjetor 2003, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në bazë të vendimit të saj nr.25/2002, Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin se dekreti presidencial mbi emërimin e një prokurori ose heqja nga posti i këtij të fundit ishte një akt administrativ, i cili duhej të ishte i ndryshueshëm përpara një rishqyrtimi juridik. Duke qenë se Gjykata e Lartë nuk e kishte ekzaminuar cilësinë e apelit të Prokurorisë së Përgjithshme, çështja u shty për të përcaktuar cilësinë.

B. Procedurat e rishqyrtimit të çështjes

Në 29 qershor 2004, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbajtën një seancë dëgjimore. Aplikuesi argumentoi se transferimi i tij nuk ishte i justifikuar. Ai ishte i mendimit se termi “opinion” në paragrafin 24 të Akteve të Prokurorisë duhej të interpretohej si “mirëkuptim”. Më tej ai pohoi se transferimi, i cili rezultoi në rënien e tij në detyrë dhe në një pakësim të fitimeve të tij, ishte joligjor.

Prokuroria e Përgjithshme argumentoi se transferimi ishte bazuar në nevojat organizative të prokurorisë. Pëlqimi i prokurorit për transferimin e tij nuk ishte i domosdoshëm. Edhe prokurorë të tjerë ishin transferuar kundër dëshirës së tyre.

Në 1 korrik 2004, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shfuqizuan vendimin e Gjykatës së Apelit me 10 vota kundër 6 të tillave, si edhe hodhën poshtë kërkesat e aplikuesit. Ata vendosën se transferimi i aplikuesit kishte ndodhur “për efekt të nevojës dhe të interesit të punës”, në përputhje me paragrafin 24 të aktit të prokurorisë. Më tej, u deklarua se ligji nuk e kërkonte

pëlqimin e aplikuesit për transferimin e tij. Ligji parashikonte vetëm që aplikuesit t'i kërkohej opinionimi përpara transferimit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e njihnin të drejtën e aplikuesit për të kërkuar kompensim për humbjen e fitimeve dhe të tjerave përfitime. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e aplikuesit i drejtohej karakterit të paligjshëm të dekretit presidencial, si edhe duke qenë se Gjykata e Apelit nuk e kishte shqyrtuar kërkesën e tij për kompensim, Gjykata e Lartë nuk mund ta shqyrtonte atë kërkesë që e kishte parashtruar edhe vetë. Megjithatë, ajo vendosi se aplikuesi mund ta paraqiste rishtazi një kërkesë për kompensimin e humbjes së të ardhurave. Deri më sot, nuk rezulton që aplikuesi të ketë paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim nga Gjykata e Rrethit.

Nga 10 gjykatësit e Gjykatës së Lartë, të cilët votuan kundër çështjes më 1 korrik 2004, 8 kishin qenë anëtarë të kolegjit, i cili e kishte pezulluar çështjen në 30 janar 2003.

Në 29 qershor 2006, aplikuesi apeloj në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk e pranoi vendimin e datës 1 korrik 2004. Ai deklaroi se çështja e tij, gjatë procedurave të rishqyrtimit, nuk ishte gjykuar nga “një gjykatë e organizuar në bazë të ligjeve”. Duke qenë se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk synonte vendosjen e një harmonie dhe unifikimin në praktikën juridike, aplikuesi argumentoi se çështja e tij gjatë procedurave të rishqyrtimit duhej të ishte gjykuar nga një Dhomë në vend që të gjykohej nga Kolegjet e Bashkuara. Gjithashtu, ai u ankua se pavarësisht kërkesës së tij për kompensim, refuzimi i Gjykatës së Lartë për ta kompensuar atë për dëmin e shkaktuar nga si rezultat i transferimit të tij dhe uljes në detyrë ishte kundër ligjit (shiko “Ligji dhe praktika përkatëse vendase”, seksioni i mëposhtëm). Sipas këndvështrimit të tij, ky vendim demonstronte mungesën e drejtësisë.

Në 3 maj 2007, Gjykata Kushtetuese, me anë të një vendimi të shqyrtuar më parë, e kundërshtonte apelimin e aplikuesit. Ajo arriti në konkluzionin se nuk kishte patur asnjë thyerje të së drejtës së aplikuesit për t'u paraqitur në gjykatë me pretendimin se gjykata nuk kishte shqyrtuar kërkesën e tij shtesë në lidhje me dëmet. Gjykata Kushtetuese vendosi se kërkesa e tij për kompensim, e paraqitur në Gjykatën e Apelit, nuk përmbushte kërkesat e një akti civil dhe si rezultat, kërkesa nuk u mor në shqyrtim. Kështu, edhe gjykatat e ulëta nuk ishin të detyruara ta shqyrtonin kërkesën. Megjithatë, Gjykata e Lartë e kishte informuar aplikuesin mbi të drejtën e tij për paraqitjen e një padie të re civile në lidhje me dëmet ndaj tij.

Më tej, Gjykata Kushtetuese vendosi se shqyrtimi i çështjes nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ishte realizuar sipas një gjykimi bazuar në ligj. Ajo doli në konkluzionin se ankesa e aplikuesit në lidhje me mungesën e drejtësisë nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë procedurave të rishqyrtimit të çështjes, ishte e padrejtë.

C. Artikujt e publikuar

Në një artikull me titullin “Rishqyrtimi juridik i ligjshmërisë së akteve administrative”, i publikuar në një gazetë ligjore, në nëntor të vitit 2002, kryetari i atëhershëm i Gjykatës së Lartë arriti në përfundimin se dekretet presidenciale që kanë të bëjnë me emërimin në një pozicion të caktuar, pushimin nga puna ose gradimin e ushtarakëve, prokurorëve ose ambasadorëve, nuk mund të bëhen subjekt i rishqyrtimeve juridike.

D. Praktika dhe ligji përkatës vendas

1. Kushtetuta e Shqipërisë

Sipas nenit 131 (f), Gjykata Kushtetuese vendos se “ankesat përfundimtare të individëve, të cilët pretendojnë se ka pasur thyerje të të drejtave të tyre kushtetuese, mund të kalojnë në një proces të drejtë, pasi të gjitha mjetet ligjore, për mbrojtjen e këtyre të drejtave, tashmë janë konsumuar.”

Neni 141 § 2 përcakton se Gjykata e Lartë mbledhet në Kolegjet e Bashkuara për të shqyrtuar çështjet që do të përmirësonin ose do të ndryshonin praktikën juridike.

Neni 148 siguron se Prokuroria është një institucion i centralizuar.

2. Akti i Gjykatës së Lartë (organizimi dhe veprimtaria) (ligji nr.8588) i datës 15 mars 2000

Gjykata e Lartë përbëhet nga 17 gjyqtarë (paragrafi 1). Ajo shqyrton çështjet në sektorin civil dhe atë penal (paragrafi 10). Ajo mbledhet në Kolegjet e Bashkuara në mënyrë që të përmirësojë dhe të ndryshojë praktikën juridike (paragrafi 14). Kërkesa për t'u mbledhur në Kolegjet e Bashkuara bëhet nga një prej kolegjeve, nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, ose nga vetë Kolegjet e Bashkuara (paragrafi 17). Korumi për përbërjen e Kolegjeve të Bashkuara është dy e treta e të gjithë gjyqtarëve. Vendimi merret nga shumica e Kolegjeve të Bashkuara (paragrafi 16).

3. Kodi i Procedurës Civile

Procedurat Civile fillojnë në bazë të një padie civile (neni 153). Padia civile duhet të përmbajë emrin e gjykatës së cilës i adresohet, të dhënat personale dhe vendbanimin e paditësit, qëllimin e padisë, përshkrimin e fakteve, rrethanat, dokumentet dhe materialet e tjera faktike, kërkesën e paditësit dhe vlerësimin e saj (neni 154).

4. Akti i Prokurorisë (organizimi dhe veprimtaria) (ligji nr.8737) i datës 12 shkurt 2001, sipas ndryshimeve të bëra nga ligji nr.9102 i datës 10 korrik 2003.

Prokurori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë i prokurorisë (paragrafi 8 § 1). Struktura e prokurorisë përbëhet nga tre ndarje: prokurorët e gjykatave të rretheve, prokurorët e gjykatave të apelit dhe prokurorët e Gjykatës së Lartë, detyrat e të cilëve ushtrohen nga prokurorët të cilët i bashkëngjiten Prokurorisë së Përgjithshme (paragrafët 13-15).

Prokurorët e rretheve emërohen nga një dekret i Presidentit të Republikës, mbi propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi është marrë edhe opinioni i Këshillit të Prokurorisë (paragrafi 21). Përpara se të marrin përsipër detyrat e tyre, prokurorët bëjnë një betim (paragrafi 22).

Sipas aktit të prokurorisë së vitit 2001, ngritja në detyrë ose transferimi i një prokurori mund të ndodhë vetëm për nevojë dhe interes të punës. Ky vendim u finalizua nga një dekret presidencial, mbi propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi u dëgjua edhe opinioni i prokurorit (paragrafi 24).

Këshilli i Prokurorisë është përgjegjës për caktimin në detyrë dhe vlerësimin e prokurorëve. Gjithashtu, ai ekzaminon thyerjet disiplinore, si rezultat i të cilave ai ndërmerr disa masa këshillimore (paragrafët 10, 31 dhe 42). Masa disiplinore mund të apelohe kundër Gjykatës së Apelit (paragrafi 34).

5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.25 i datës 31 shkurt 2002

Çështja ka të bëjë me pamundësinë për t'u pranuar nga një gjykatë, me pretendimin për të dalë kundër dekretit presidencial, i cili urdhëron heqjen nga detyra të një prokurori, në bazë të paragrafit 34 § 2 të aktit të prokurorisë. Në vendimin e saj nr.25 të datës 13 shkurt 2002 (25/02) Gjykata Kushtetuese e deklaroi jokushtetues paragrafin 34 § 2, duke qenë se binte në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës. Në këtë mënyrë, ajo i krijon mundësinë një prokurori të kundërshtojë një dekret presidencial duke urdhëruar përpara një gjykatë heqjen e tij nga detyra.

6. Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.31 i datës 26 mars 2003

Çështja ka të bëjë me shkarkimin e padrejtë nga detyra të një oficeri policie dhe të drejtën e tij për zhdëmtim. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë vendimin se një oficeri policie të shkarkuar në mënyrë të padrejtë nga detyra, i jepet e drejta për kompensim për humbje të të ardhurave. Një veprim i tillë nuk kishte arsye se përse të kërkohej kaq specifikisht. Mjaftonte që oficeri i policisë të kundërshtonte pezullimin e tij të padrejtë nga detyra, për të bërë që gjykata të shqyrtonte (automatikisht) pasojat që vinin nga një pezullim i tillë, dhe që në fakt (pasojat) ishin zhdëmtimet (e kërkuara prej tij). Përgjegjësia për gjetjen e provës që përcaktonte dëmin binte mbi palën që kishte mbledhur gjyqin.

ANKESAT

Aplikuesi u ankua se kishte patur thyerje të së drejtës së tij gjatë paraqitjes në gjykatë, duke pretenduar se gjykatat vendase nuk e kishin marrë në shqyrtim kërkesën e tij për kompensim. Me tej, ai pohoi se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të datës 30 janar 2003 dhe 1 korrik 2004, nuk kishin qenë të drejtë në gjykim. Së fundmi, ai pretendonte se procedurat e rishqyrtimit të çështjes kishin qenë të paligjshme dhe ishin kryer nga një gjykatë e cila nuk ishte e miratuar nga ligji.

A. Ankesat e bëra në bazë të nenit 6 § 1 të Kushtetutës

Aplikuesi paraqiti tre ankesa thelbësore, në bazë të nenit 6 të Konventës, duke deklaruar se kishte patur thyerje të së drejtës së tij nga ana e gjykatës, se ishte gjykuar nga një gjykatë e cila nuk ishte e drejtë dhe e paanshme, dhe se çështja e tij ishte shqyrtuar nga një gjykatë e cila nuk ishte e miratuar nga ligji.

Për sa ka të bëjë me këtë çështje, neni 6 § 1 i Konventës pohon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile çdo individ ka të drejtën ... për të kërkuar mbledhjen e një seance gjyqësore ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e miratuar nga ligji”.

Për sa ka të bëjë me pretendimin për mospërputhshmëri me *ratione materiae*

a) Kërkesat e palëve

Qeveria parashtrroi kundërshtinë e saj në lidhje me procedurat në fjalë, pra, mbi ligjshmërinë e dekretit të Kryetarit për sa ka të bëjë me transferimin e aplikuesit, duke qenë se ky dekret nuk ka të bëjë me përcaktimin e të drejtës “civile” të parashikuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Sipas dekretit të Kryetarit, mospranimi i kërkesës së aplikuesit për kompensim si rezultat i transferimit të tij, e bënte të pavlefshëm nenin 6 § 1 (Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shtator 1994, § 65, seria A nr.294-B dhe Neigel kundër Francës, 17 mars 1997, §§ 43-44, raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1997-II).

Më tej, qeveria pohoi se ekzistonte një marrëdhënie e veçantë punësimi midis prokurorëve dhe Shtetit, e cila manifestohej në betimin e prokurorit për të vepruar si mbajtës i autoritetit publik në mbrojtje të interesave të publikut. Karakteri i centralizuar i prokurorisë dhe përgjegjësia e madhe e prokurorëve për të përfaqësuar Shtetin gjatë procedurave penale dilte kundër zbatimit të nenit 6 § 1 të Kushtetutës. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se prokurorët nuk cilësoheshin si nëpunës civil. Ajo pohoi se ligji vendas nuk e garantonte të drejtën për kthimin në detyrë, kështu që neni 6 nuk mund të aplikohet në çështjen konkrete të aplikuesit (shiko Stanczuk kundër Polonisë (vendim), nr. 45004/98, 14 qershor 2001).

Sipas kriterit të Gjykatës, në çështjen Vilho Eskelinen dhe të Tjerët kundër Finlandës (Gjykata e Përgjithshme), nr.63235/00, § 62, ECHR 2007-IV, aplikuesi kundërshtoi duke qenë se gjykatat vendase i kishin njohur të drejtën për t'u paraqitur në gjykatë, neni 6 §1 i Konventës i aplikuar në çështjen në fjalë.

b) Kërkesa e Gjykatës

Fillimisht, Gjykata do të shqyrtojë nëse ekziston një e “drejtë” për çështjen në fjalë brenda kontekstit të nenit 6 të Konventës. Sipas parimeve të parashtruara në çështjen gjyqësore, diskutimi mbi të “drejtën”, e cila të paktën në aspektin parimor duhet të shqyrtohet sipas ligjit vendas, duhet të jetë i vërtetë dhe serioz; ai nuk duhet të përqëndrohet vetëm në ekzistencën aktuale të një të drejte, por edhe në qëllimin dhe mënyrën e ushtrimit të saj, dhe së fundmi, rezultati i procedurave duhet të jetë vendimtar për të drejtën në fjalë (shiko Vilho Eskelinen dhe të Tjerët, cituar më sipër, § 40).

Gjykata studion procedurat vendase në lidhje me debatin e punësimit, mbi transferimin e propozuar të aplikuesit kundër dëshirës së tij në një tjetër prokurori rrethi. Gjykata mendon se

kundrejt një situatë të tillë, aplikuesi duhet të bëjë kërkesën për të patur një të drejtë që t'i njihet nga ligji vendas, për të kundërshtuar kështu, transferimin në bazë të natyrës së tij joligjore.

Gjykata përsërit në lidhje me këtë çështje, vendimin e saj të marrë në gjykimin e çështjes Vilho Eskelinen dhe të Tjerët (e cituar më sipër), se të dyja kushtet duhet të përmbushen, në mënyrë që kur Shteti përgjegjës të jetë përpara Gjykatës të mbështetet mbi statusin e aplikuesit si nëpunës civil, duke e përjashtuar atë nga mbrojtja që parashtrohet në nenin 6. Së pari, Shteti, në legjislaturën vendase, duhet të përjashtojë, për postin ose kategorinë e stafit në fjalë, të drejtën për t'u paraqitur përpara një gjykate. Së dyti, përjashtimi duhet të justifikohet mbi baza objektive në interes të Shtetit (po aty, § 62).

Që prej hyrjes në fuqi të vendimit të mësipërm, Gjykata ka vendosur që neni 6 të aplikohet në procedurat disiplinore kundër gjykatësve (shiko G kundër Finlandës, nr. 33173/05, §§ 31-35, 27 janar 2009; dhe Olujić kundër Kroacisë, nr.22330/05, §§ 34 dhe 44, 5 shkurt 2009), oficerëve të policisë (shiko Vanjak kundër Kroacisë, nr.29889/04, §§ 30-33, 14 janar 2010), dhe nëpunësve të gjykatave (shiko Bayer kundër Gjermanisë, nr.8453/04, §§ 37-39, 16 korrik 2009); ashtu si edhe ndaj procedurave përjashtuese të studentëve ushtarakë nga shkollat trajnuese ushtarake (Çatak kundër Turqisë, nr.26718/05, § 13, 6 tetor 2009), si edhe në procedurat në lidhje me kompensimin e ushtarakëve (shiko Lelas kundër Kroacisë, nr.55555/08, §§ 42-44, 20 maj 2010; Kuzmina kundër Rusisë, me numrat 2068-03, 2076-03, 5224/03, 5385/03, 5414/03 dhe 5656/03, §§ 14-17, 8 janar 2009); dhe në rastet e mos zbatimit të procedurave për një ushtarak të mëparshëm (shiko Bormotov kundër Rusisë, nr. 24435/04, §§ 11-15, 31 korrik 2008).

Duke iu rikthyer çështjes aktuale, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e rishqyrtoi kërkesën e aplikuesit më 1 korrik 2004, për sa i përket pretendimit për mungesë ligjshmërie nga ana e dekretit presidencial i cili urdhëron transferimin e tij. Ndërkohë, ndërsa është i vërtetë fakti se kërkesa e tij u kundërshtua përfundimisht, Gjykata e Lartë, duke vlerësuar vlerat e aplikimit, i dha të drejtë aplikuesit. Për këtë arsye, ai ka të drejtë të paraqitet përpara një gjykate për të kundërshtuar dekretin e kryetarit që urdhëronte transferimin e tij, si rezultat i të cilit u prekën interesat e tij në të ardhura.

Gjykata konkludon se neni 6 mund të aplikohet në procedurat vendase në fjalë. Për pasojë, ajo e hedh poshtë këtë kundërshtim.

2. Mbi pretendimin për mungesë drejtësie dhe paanshmërie të Gjykatës së Lartë

a) Kërkesat e palëve

Qeveria parashtrroi faktin se edhe pse Gjykata e Lartë e rishqyrtoi çështjen e aplikuesit në vijim të ndjesës nga Gjykata Kushtetuese, asnjë shenjë njëanshmërie dhe mungese drejtësie nuk ishte vënë re nga ana e Kolegjeve të Bashkuara. Sipas një letre shpjeguese nga Gjykata e Lartë, Qeveria e kundërshtoi bindjen se vendimi i datës 30 janar 2003 nuk kishte përcaktuar pikat thelbësore të çështjes së aplikuesit. Thelbi i ankesës së tij ishte shqyrtuar dhe përcaktuar nga vendimi i datës 1 korrik 2004.

Në lidhje me mungesën e paanshmërisë nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 30 janar 2003, Qeveria shtoi se aplikuesi nuk kishte përfshirë një ankesë të tillë në apelin e tij kushtetues të datës 10 qershor 2003. Gjithashtu, Qeveria kundërshtoi faktin se ankesa e aplikuesit për mungesë paanshmërie nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të datës 1 korrik 2004, nuk ishte argumentuar.

Aplikuesi nënshtroi çështjen se publikimi i një studimi nga Presidenti i atëhershëm i Gjykatës së Lartë në një gazetë ligjore në nëntor të vitit 2002, mbi një përmbledhje juridike të akteve administrative, veçanërisht mbi dekretet presidenciale, i kishte paragjykuar dukshëm pikat thelbësore të çështjes së tij së datës 30 janar 2003 (shiko Buscemi kundër Italisë, nr.29569/95, ECHR 1999-VI dhe Kyprianou kundër Qipros (Gjykata e Përgjithshme), nr.73797/01, ECHR 2005-XIII). Për të mbrojtur pikëpamjen se dekretet presidenciale nuk mund të bëheshin subjekt për shqyrtime juridike, Presidenti i atëhershëm i Gjykatës së Lartë kishte vendosur ta paraqiste çështjen e aplikuesit përpara Kolegjeve të Bashkuara, duke vënë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë dhe vendimin e saj të datës 30 janar 2003.

b) Vendimi i Gjykatës

i) Pretendimi për mungesë paanshmërie nga ana e Gjykatës së Lartë i datës 30 janar 2003

Gjykata përsërit se rregulli i shfrytëzimit të mjeteve juridike të brendshme, i artikuluar në nenin 35 § 1 të Konventës i detyron aplikantët të përdorin format juridike të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin ligjor vendas, duke bërë të mundur që ata të shpaguehen për thyerjet e ligjit që ata pretendojnë se janë bërë ndaj tyre. Ekzistenca e këtyre formave duhet të jetë e sigurt, si në praktikë, ashtu edhe në teori (në të kundërt do të ketë mungesa të këtyre formave të domosdoshme por edhe mungesë efektshmërie). I takon Shtetit përgjegjës për të përcaktuar nëse këto kushte të natyrave të ndryshme janë të kënaqshme (shiko çështjen më të afërt, Demopoulos dhe të Tjerët kundër Turqisë, (vendimet) 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04, §§ 69-70, ECHR 2010-...).

Në çështjen në fjalë, Gjykata shqyrton ankesën e aplikuesit për mungesë paanshmërie nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Lartë gjatë proceseve gjyqësore të cilat sollën vendimin e datës 30 janar 2003 për herë të parë në këtë Gjykatë. Ai nuk arriti ta paraqesë një ankesë të tillë në apelin e tij kushtetues të datës 10 qershor 2003 përpara Gjykatës Kushtetuese, veprim i cili është një formë juridike për t'u konsumuar në raste ankesash sipas nenit 6 të Konventës (shiko Balliu kundër Shqipërisë (vendim), nr.74727/01, 30 shtator 2004; Beshiri dhe të Tjerë kundër Shqipërisë, nr.7352/03, § 32; 22 gusht 2006; dhe Jakupi kundër Shqipërisë (vendim), nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009) ose në proceset gjyqësore përmbyllëse.

Më pas vijohet me faktin se kjo pjesë e ankesës duhet të anashkalohej për mosshfrytëzim të formave juridike vendase në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

ii) Pretendimi për mungesë anshmërie nga ana e Gjykatës së Lartë i datës 1 korrik 2004

Normalisht paanshmëria tregon mungesën e paragjykimeve ose anshmërive dhe ekzistenca e saj mund të testohet në mënyra të ndryshme. Sipas çështjes gjyqësore aktuale të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë sipas qëllimeve të nenit 6 §1 duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv ku duhet të meret parasysh bindja dhe sjellja personale e një gjykatësi të caktuar, detaj i cili tregon nëse gjykatësi mbart ndonjë paragjykim ose anshmëri personale në një çështje të caktuar; por gjithashtu paanshmëria mund të përcaktohet edhe sipas një testi objektiv, që do të thotë të sigurohesh nëse vetë gjykata dhe përbërja e saj ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj (shiko Micallef kundër Maltës (Gjykata e Përgjithshme), nr.17056/06, §§ 93, ECHR 2009-...).

Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se nuk ka asnjë të dhënë se 6 gjyqtarët të cilët votuan kundër aplikuesit më 1 korrik 2004 dhe që gjithashtu e pezulluan çështjen e tij më 30 janar 2003, të kenë shfaqur anshmëri personale. Për këtë arsye ajo do ta shqyrtojë çështjen me anë të kontrollit objektiv të paanshmërisë, i cili do të sigurojë një garanci më shumë.

Në vijim, Gjykata vëren se më 30 janar 2003 Gjykata e Lartë vendosi të ndërpriste ndjekjen e kësaj çështjeje duke pretenduar se dekreti presidencial nuk mund t'i nënshtrohej ndryshimeve të një shqyrtimi juridik. Një vendim i tillë përforcohet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 23 dhjetor 2003, i cili e shtyn çështjen për të lënë kohë për përcaktimin e cilësive të saj.

Vetëm më 1 korrik 2004, Gjykata e Lartë shqyrtoi cilësitë e çështjes dhe konkludoi se transferimi i aplikuesit kishte qenë i ligjshëm. Në bazë të arsyetimeve të mësipërme çdo dyshim për mungesë paanshmërie nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 1 korrik 2004 nuk është i justifikueshëm objektivisht (shiko Berhani kundër Shqipërisë, nr.847/05, §§ 63-77, 27 maj 2010).

Gjykata e konsideron këtë ankesë si të padrejtë sipas nenit 35 § 3 dhe të papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

3. Për sa i përket ankesës se Gjykata e Lartë e datës 1 qershor 2004 nuk organizoi “një gjyq të miratuar nga ligji”

a) Kërkesat e palëve

Qeveria pohoi se në përputhje me aktin e Gjykatës së Lartë, të gjithë gjykatësit u paraqitën në Kolegjet e Bashkuara në datë 30 janar 2003. Kalimi i çështjes së aplikuesit në Gjykatën e Lartë, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 23 dhjetor 2003, llogjikisht solli edhe rishqyrtimin e saj nga Kolegjet e Bashkuara në 1 korrik 2004. Sipas Qeverisë, do të ishte e paarsyeshme që një çështje të rishqyrtohej nga një Dhomë e Gjykatës së Lartë, në kohën kur tashmë ishte marë një vendim mbi këtë çështje nga Kolegjet e Bashkuara, i cili ishte shfuqizuar më pas nga Gjykata Kushtetuese.

Më tej, aplikuesi argumentoi se nuk kishte arsye objektive se pse Gjykata e Lartë të rishqyrtonte çështjen e tij në Kolegjet e Bashkuara më 1 korrik 2004.

b) Vendimi i Gjykatës

Gjykata rithekson faktin se sipas nenit 6 § 1 (një gjyq) duhet “të organizohet gjithmonë sipas ligjit”. Kjo frazë reflekton parimin e rregullit të ligjit, i cili është i pandashëm në të gjithë sistemin e Kushtetutës dhe protokolleve të saj. Një strukturë e cila nuk organizohet në përputhje me parimet e legjislaturës, do të humbasë përfundimisht legjitimitetin e kërkuar në një shoqëri demokratike për shqyrtimin e çështjeve individuale. Shprehja “e organizuar nga ligji” nuk mbulon vetëm aspektin ligjor të ekzistencës së çdo gjyqësori, por edhe përbërjen e trupit gjykues në çdo çështje (shiko Lavents kundër Lituanisë, nr.58442/00, § 114, 28 nëntor 2002). “Ligji” i parashtuar nga neni 6§1, nuk përfshin vetëm legjislationin në lidhje me organizimin dhe juridiksionin e gjykatave, por gjithashtu edhe çdo nen të ligjit vendor, në mungesë të të cilit mund të shtohen edhe një ose më shumë gjykatës në mënyrë të paligjshme. Të tilla masa lidhen veçanërisht me rrethanat në zyrën e gjykatësve, në skualifikimet dhe sfidat ndaj tyre (shiko Coëme dhe të Tjerët kundër Belgjikës, me numër 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, § 99, ECHR 2000-VII).

Në lidhje me çështjen në fjalë, pretendimi i aplikuesit lidhet me faktin se rishqyrtimi i aplikimit të tij nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vend që të rishqyrtohej nga një Dhomë, u drejtua nga një gjykatë e cila nuk ishte e organizuar nga ligji.

Në këto rrethana, Gjykata pohon se më 30 janar 2003 çështja e aplikuesit u deklarua e papranueshme nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më 23 dhjetor 2003 Gjykata Kushtetuese pezulloi vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe e shtyu çështjen për të përcaktuar cilësitë e saj. Gjykata nuk e merr parasysh se shqyrtimi i çështjes nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, më 1 korrik 2004 ishte një praktikë e gabuar e statuteve që kanë të bëjnë me organizimin e sistemit ligjor vendas. Në përputhje me këtë, Gjykata nuk vëren ndonjë thyerje të legjislationit vendas. Gjykata e Lartë e datës 1 korrik 2004 ishte një “gjyqësor i organizuar nga ligji” sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Për pasojë, ankimi është i pavend dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

4. Në lidhje me pretendimin se i është mohuar e drejta për t’u paraqitur në gjykatë me kërkesën për kompensim

a) Kërkesat e palëve

Qeveria e kundërshtoi faktin se kërkesa e aplikuesit për dëmet të kishte të bënte me kërkesën kryesore civile për ligjshmërinë e dekretit të kryetarit. Kundërshtimi i kërkesës kryesore nga Gjykata e Lartë më 1 korrik 2004, solli në të njëjtën kohë edhe mospranimin e kërkesës për dëmet, të cilat kryesisht ishin të lidhura dhe bazoheshin në kërkesën kryesore.

Aplikuesi pretendonte se kishte patur një thyerje të së drejtës së tij për t’u paraqitur në gjykatë.

b) Vendimi i Gjykatës

Neni 6 § 1 i siguron të gjithëve të drejtën për të bërë çdo lloj kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile të sjella përpara një gjykate. Në këtë mënyrë ai përfshin “të drejtën për në gjykatë”, e cila është e drejta për t’i institucionalizuar proceset gjyqësore përpara gjykatave në çështjet civile. Kjo e drejtë përbën një aspekt (shiko Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykim i datës 21 shkurt 1975, seria A nr.18, faqe 17-18, §§ 35-36).

“E drejta për t’u paraqitur në gjykatë” nuk është absolute, ajo është subjekti i kufizimeve të lejuara, në veçanti në rastet kur kushtet e pranimit të një apeli janë të paqarta, duke qenë se nga vetë natyra e saj ajo ka nevojë për rregulla nga shteti, i cili ka një pozicion të caktuar vlerësues (shiko Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 28 maj 1985, seria A nr.93, faqe 24-25, § 57).

Gjykata vëren se në një datë të papërcaktuar aplikuesi ka arkivuar një kërkesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar kompensim për humbjen e fitimeve si rezultat i transferimit të tij në mënyrë të paligjshme në një tjetër prokurori rrethi. Në vendimin final të datës 1 korrik 2004 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkluduan se transferimi i aplikuesit kishte qenë i ligjshëm.

Gjykata vëren se gjykatat vendase kanë vënë në përdorim një strukturë ligjore të mirëorganizuar sipas së cilës padrejtësitë ose sjelljet e paligjshme në çështjet e lidhura me punësimin mund të sjellin të drejtën për kompensim në favor të punëmarrësit. Duke qenë se transferimi i aplikuesit rezultoi të ishte i drejtë dhe i ligjshëm, Gjykata merr vendimin se kërkesa e tij për kompensim nuk kishte vend për diskutim sipas ligjit vendas. Për më tepër gjykatat vendase i shpjeguan aplikuesit se varej nga ai vetë nëse do të donte të arkivonte një kërkesë për dëmet e shkaktuara duke qenë se ai kishte patur humbje financiare pavarësisht faktit se transferimi i tij kishte qenë i ligjshëm. Në lidhje me këtë fakt Gjykata vendos se nuk ka patur thyerje të së drejtës së aplikuesit në gjykatë.

Për këtë arsye kjo ankesë është konsideruar e padrejtë dhe duhet të kundërshtohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

b) Ankesa në bazë të nenit 13 të Konventës

Aplikuesi u ankua se ai ishte privuar nga e drejta për zhdëmtim, duke qenë se nuk kishte mundësi të apelonte kundër dekretit presidencial.

Neni 13 i Konventës pohon si më poshtë:

“Çdo individ, të drejtat dhe liritë e të cilit, ashtu siç parashikohet në Konventë, janë dhunuar, do të përfitojë zhdëmtim përpara një autoriteti kombëtar edhe në rastet kur dhunimi është kryer nga persona me detyra zyrtare.”

Qeveria deklaroi se nuk kishte patur asnjë thyerje të nenit 13 të Konventës, në lidhje me ankesën e aplikuesit për pamundësinë për të kundërshtuar dekretin e kryetarit që kishte urdhëruar transferimin e tij. Sipas saj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 23 dhjetor 2003 e kishte zhdëmtuar dhunën që ishte ushtruar.

Gjykata deklaroi se neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë e zhdëmtimit në nivel kombëtar, duke përforcuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës të cilat pavarësisht formës duhet të jenë të sigurta në sistemin ligjor vendas. Kështu, neni 13 kërkon parashikimin e zhdëmtimit vendas, për të mbuluar thelbin e një “kërkese të diskutueshme” sipas Konventës dhe për të siguruar lehtësirat e duhura (shiko Kudla kundër Polonisë (Gjykata e Përgjithshme), nr.30210/96, § 157, ECHR 2000-XI).

Në rastin konkret, Gjykata vëren se aplikuesi parashtron një apel kushtetues, me Gjykatën Kushtetuese, kundër pamundësisë së tij për të sfiduar dekretin presidencial përpara gjykatave vendase. Më 23 dhjetor 2003, Gjykata Kushtetuese mori një vendim në favor të aplikuesit dhe deklaroi se dekreti presidencial ishte i ndryshueshëm përpara një shqyrtimi juridik. Nën rrethana të tilla, çështja iu dorëzua Gjykatës së Lartë për një shqyrtim të ri. Gjykata e Lartë shqyrtoi cilësitë e çështjes. Gjykata vendosi se zhdëmtimi i paraqitur në Gjykatën Kushtetuese ishte efektiv.

Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kjo pjesë e aplikimit duhet kundërshtuar duke e përcaktuar si të pavend dhe të papranueshme në bazë të nenit 35 §§ 3 dhe 4.

Për këto arsye, Gjykata në mënyrë unanime:

E deklaroi aplikimin të papranueshëm.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
President

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 11.4.2011
Doli nga shtypi më 13.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 12 lekë